R E L A C I O N

PËR

PROJEKTLIGJIN "PËR DONACIONET DHE SPONSORIZIMET''

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji "Për donacionet dhe sponsorizimet" synon të nxisë donacionet dhe sponsorizimet për realizimin e veprimtarive me interes publik në Republikën e Shqipërisë, si dhe të përcaktojë parimet, rregullat e procedurat për mbështetjen e këtyre veprimtarive. Nëpërmjet projektligjit synohet gjithashtu garantimi i transparencës, integritetit institucional dhe gjurmueshmërisë së sponsorizimeve, zbatimi i rregullave për përfitimin e lehtësive tatimore, si dhe parandalimi i konfliktit të interesit, korrupsionit, pastrimit të produkteve të veprës penale, financimit të terrorizmit dhe shmangies së detyrimeve ligjore.

Projektligji është hartuar me qëllim përmirësimin dhe konsolidimin e kuadrit ligjor për donacionet e sponsorizimet dhe krijimin e mekanizmave më të qartë për pranimin, dokumentimin, verifikimin, deklarimin, regjistrimin e kontrollin e tyre. Në këtë kuadër, përcaktohen rregulla për subjektet, që mund të jenë donatorë, sponsorizues dhe përfitues, kushtet e kufizimet për pranimin e donacioneve dhe të sponsorizimeve, si dhe detyrimet e subjekteve të përfshira në këto marrëdhënie.

Kuadri ligjor aktual për sponsorizimet mbështetet në ligjin nr.7892, datë 21.12.1994, "Për sponsorizimet", të ndryshuar. Evoluimi i marrëdhënieve ekonomike dhe shoqërore, nevoja për rritjen e transparencës dhe gjurmueshmërisë së sponsorizimeve, forcimin e integritetit institucional dhe përshtatjen e mekanizmave të kontrollit dhe raportimit kanë bërë të nevojshëm hartimin e një kuadri të ri ligjor. Projektligji parashikon shfuqizimin e ligjit nr.7892, datë 21.12.1994, "Për sponsorizimet", të ndryshuar, dhe vendos një regjim të ri të integruar për donacionet e sponsorizimet.

Projektligji përcakton fushat e veprimtarisë me interes publik, që mund të mbështeten nëpërmjet donacioneve dhe sponsorizimeve, ku përfshihen shërbimet sociale dhe veprimtaritë humanitare, arti, kultura dhe mbrojtja e trashëgimisë, zhvillimi dhe edukimi i fëmijëve dhe i të rinjve, shëndeti publik dhe kujdesi shëndetësor, mbrojtja e mjedisit dhe e klimës, sporti, infrastruktura sportive dhe edukimi fizik, arsimi, rinia, kërkimi shkencor, inovacioni dhe transformimi digjital, të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore, demokracia, shteti i së drejtës, mirëqeverisja dhe lufta kundër korrupsionit, liria e medias, si dhe projektet infrastrukturore publike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit,

përfshirë projektet që kontribuojnë në rritjen e sigurisë rrugore.

Projektligji përcakton gjithashtu subjektet përfituese. Organet publike mund të përfitojnë donacione dhe sponsorizime sipas kushteve të përcaktuara në projektligj, ndërsa për sponsorizimet parashikohen si përfitues edhe organizatat jofitimprurëse, organizatat sportive, shoqëritë sportive, subjektet tregtare në fushën e prodhimit të filmit dhe industrisë audiovizive, botuesit e shtypit, të botimeve shkencore dhe enciklopedike, si dhe individët që përfaqësojnë Republikën e Shqipërisë në aktivitete ndërkombëtare në fushën e artit, sportit dhe kulturës. Sindikatat dhe partitë politike përjashtohen nga zbatimi i këtij ligji.

Për të garantuar ligjshmërinë dhe integritetin e marrëdhënieve të donacionit dhe sponsorizimit, projektligji përcakton kufizime për kategoritë e personave që mund të jenë donatorë ose sponsorizues, kërkesa për dokumentacionin dhe verifikimin e tyre, ndalimin e donacioneve dhe sponsorizimeve anonime, si dhe rregulla të posaçme për shmangien e konfliktit të interesit. Për sponsorizimet parashikohet detyrimi i lidhjes së kontratës me shkrim, në të cilën përcaktohen objekti, qëllimi, forma, vlera, destinacioni dhe përdorimi i sponsorizimit, mënyra e promovimit të sponsorizuesit dhe detyrimet për dokumentimin e raportimin.

Një element i rëndësishëm i projektligjit është krijimi i bazës së të dhënave shtetërore "Regjistri Elektronik Kombëtar i Sponsorizimeve", i cili administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Regjistri krijohet, administrohet, funksionon e ndërvepron me bazat e tjera të të dhënave shtetërore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore, qeverisjen elektronike, sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Të gjitha sponsorizimet, pavarësisht vlerës së tyre, regjistrohen në Regjistër, ndërsa deklarimi dhe regjistrimi kryhen nëpërmjet shërbimit elektronik të posaçëm në platformën qeveritare "*e-Albania*". Projektligji përcakton të dhënat parësore dhe dytësore të Regjistrit, dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera shtetërore të të dhënave, afatet e regjistrimit, nivelet e aksesit dhe rregullat për publikimin dhe mbrojtjen e të dhënave.

Projektligji parashikon një regjim të posaçëm të lehtësive tatimore. Për sponsorizimet në fushat e artit, kulturës dhe sportit, sponsorizuesve, që kanë detyrim për pagesën e tatimit mbi fitimin, u njihet zbritja e shumës së sponsorizuar e të dokumentuar deri në masën 30 për qind të tatimfitimit të vitit paraardhës fiskal, në përputhje me kushtet e përcaktuara në projektligj. Shuma maksimale vjetore e sponsorizimeve për një sponsorizues, për të cilat zbatohet kjo zbritje, përcaktohet në 30 000 000 lekë, ndërsa vlera totale vjetore e sponsorizimeve, që përfshihen në këtë mekanizëm, nuk mund të tejkalojë 2 000 000 000 lekë.

Projektligji përcakton gjithashtu trajtimin tatimor të të ardhurave të përfituara nga sponsorizimi. Këto të ardhura përjashtohen nga tatimi për përfituesin e sponsorizimit. Përjashtimisht, shumat e përdorura nga fondet e sponsorizimit për pagesën e shpërblimeve ose të honorarëve i nënshtrohen tatimit në burim, i cili paguhet nga subjekti përfitues, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat. Ky rregull synon të ruajë karakterin nxitës të sponsorizimit, pa përjashtuar nga tatimi të ardhurat individuale, që realizohen në formën e shpërblimeve ose honorarëve.

Për zbatimin e këtij regjimi, përpara lidhjes së kontratës së sponsorizimit, ministria përgjegjëse për artin, kulturën dhe sportin, me kërkesë të përfituesit, lëshon vërtetimin se veprimtaria, objekt sponsorizimi, zhvillohet në fushën e artit, kulturës ose sportit dhe përbën veprimtari me interes publik. Vërtetimi lëshohet brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës së plotë dhe nuk përbën vendim për përfitimin e lehtësisë tatimore. Përfitimi i lehtësisë lidhet gjithashtu me autorizimin përkatës të drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, sipas procedurave që përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për artin, kulturën dhe sportin.

Projektligji forcon edhe mekanizmat e kontrollit dhe raportimit. Donacionet dhe sponsorizimet u nënshtrohen kontrollit financiar dhe auditimit të jashtëm publik sipas legjislacionit në fuqi, ndërsa organet tatimore kanë të drejtë të kryejnë verifikimet dhe kontrollet e nevojshme. Për sponsorizimet parashikohet raportimi për zbatimin e kontratës dhe përdorimin e sponsorizimit, si dhe regjistrimi i raportit përkatës në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve.

Një rregullim i posaçëm parashikohet për donacionet në organet publike. Projektligji përcakton verifikimin paraprak të konfliktit të interesit dhe të kushteve ndaluese për donatorët, detyrimin për formalizimin me marrëveshje të shkruar të donacioneve financiare me vlerë të barabartë ose më të madhe se 300 000 lekë ose që arrijnë në mënyrë kumulative këtë vlerë nga i njëjti donator brenda një viti kalendarik, si dhe detyrimet për evidentimin, publikimin dhe raportimin e donacioneve. Për donacionet nga persona fizikë ose juridikë të huaj parashikohet marrja e miratimit të organit epror.

Për garantimin e respektimit të detyrimeve të projektligjit parashikohen masa disiplinore për nëpunësit e organeve publike dhe sanksione administrative për shkeljet e detyrimeve të deklarimit dhe regjistrimit nga subjektet e tjera përfituese. Projektligji parashikon gjithashtu humbjen e së drejtës për përfitimin e lehtësive tatimore në rastet e sponsorizimeve të pranuara në kundërshtim me kufizimet ligjore ose kur fshihen me dashje të dhënat që duhet të deklarohen në Regjistër.

Në funksion të zbatimit të ligjit, parashikohet nxjerrja e akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave, ministri përgjegjës për artin, sportin dhe kulturën, si dhe e udhëzimit të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe të ministrit përgjegjës për artin, kulturën dhe sportin, brenda afateve të përcaktuara në projektligj.

Projektligji parashikon një periudhë kalimtare për krijimin dhe vënien në funksion të Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve dhe të shërbimit elektronik përkatës. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe institucionet e tjera përgjegjëse, merr masat për krijimin dhe vënien në funksion të tyre brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. Deri në vënien në funksion të Regjistrit dhe të shërbimit elektronik, të dhënat deklarohen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe administrohen në një evidencë të përkohshme, për t'u transferuar më pas në Regjistër.

Gjithashtu, projektligji parashikon ndërhyrjet përkatëse në ligjin nr.29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, me qëllim harmonizimin e këtij ligji me regjimin e ri të sponsorizimeve dhe të lehtësive tatimore të parashikuara në projektligj.

Në tërësi, projektligji synon të krijojë një kuadër të unifikuar dhe të kontrollueshëm për donacionet dhe sponsorizimet, të rrisë transparencën dhe gjurmueshmërinë e sponsorizimeve, të forcojë integritetin institucional dhe kontrollin financiar, si dhe të krijojë mekanizma të qartë për nxitjen e mbështetjes private të veprimtarive me interes publik, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen e interesit publik dhe respektimin e kërkesave ligjore në fuqi.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KESHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TE AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin 2026.

Rishikimi i legjislacionit për sponsorizimet është i nevojshëm për forcimin e integritetit dhe të kontrollit institucional mbi burimet e sponsorizimeve. Ky proces zhvillohet në përputhje me dokumentet strategjike dhe politikat e miratuara nga qeveria shqiptare, të cilat përcaktojnë angazhimet dhe masat e nevojshme për forcimin e kuadrit ligjor në këtë fushë.

Në veçanti, ndryshimet e propozuara burojnë nga angazhimi i parashikuar në

vendimin nr.736, datë 13.12.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës".

Po ashtu, projektligji është në përputhje me vendimin nr.859, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024 - 2030, të planit të veprimit 2024 - 2026 dhe të Pasaportës së Treguesve të Performancës", i cili parashikon përgatitjen e ndryshimeve në legjislacionin për donacionet e sponsorizimet, si dhe konsolidimin e kuadrit ligjor në këtë fushë.

Ky proces vjen gjithashtu në përgjigje të pozicionit të përbashkët negociues të Bashkimit Evropian, përkatësisht të piketave të ndërmjetme (IBM) për kapitullin 23, si dhe të gjetjeve të evidentuara në raportin e shqyrtimit analitik për kapitullin 23, "Gjyqësori dhe të drejtat themelore". Në këto dokumente theksohet se kuadri ligjor i Shqipërisë në fushën e luftës kundër korrupsionit është vetëm pjesërisht i përafruar me standardet dhe *acquis* të Bashkimit Evropian.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji "Për donacionet dhe sponsorizimet" sjell një rregullim të plotë e të unifikuar të marrëdhënieve që lidhen me donacionet dhe sponsorizimet, duke zëvendësuar kuadrin ligjor ekzistues, të fokusuar kryesisht në sponsorizimet, dhe duke adresuar nevojën për rritjen e transparencës, të integritetit institucional, të gjurmueshmërisë dhe të kontrollit të këtyre marrëdhënieve. Nëpërmjet tij përcaktohen parimet, rregullat e procedurat për mbështetjen e veprimtarive me interes publik, si dhe mekanizmat për dokumentimin, deklarimin, regjistrimin, raportimin, verifikimin dhe kontrollin e donacioneve dhe sponsorizimeve.

Projektligji zgjeron dhe qartëson fushat e veprimtarive me interes publik, që mund të mbështeten nëpërmjet donacioneve dhe sponsorizimeve, duke përfshirë shërbimet sociale dhe veprimtaritë humanitare, artin, kulturën dhe mbrojtjen e trashëgimisë, zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve dhe të të rinjve, shëndetin publik dhe kujdesin shëndetësor, mbrojtjen e mjedisit e të klimës, sportin, infrastrukturën sportive dhe edukimin fizik, arsimin, rininë, kërkimin shkencor, inovacionin dhe transformimin digjital, të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore, demokracinë, shtetin e së drejtës, mirëqeverisjen dhe luftën kundër korrupsionit, lirinë e medias, si dhe projektet infrastrukturore publike në fushën e planifikimit e zhvillimit të territorit. Ky përcaktim krijon siguri juridike për subjektet e përfshira dhe qartëson fushat, në të cilat mund të orientohet mbështetja private në funksion të interesit publik.

Një nga risitë e projektligjit është përcaktimi i qartë i dallimit ndërmjet donacionit

dhe sponsorizimit. Këto dy forma mbështetjeje u nënshtrohen regjimeve të dallueshme juridike, në përputhje me natyrën dhe qëllimin e tyre, duke përcaktuar në mënyrë të qartë të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe duke shmangur paqartësitë në zbatimin praktik të ligjit. Në veçanti, për sponsorizimin parashikohet lidhja e kontratës me shkrim, ku përcaktohen, ndër të tjera, objekti, qëllimi, forma dhe vlera e sponsorizimit, destinacioni dhe mënyra e përdorimit të tij, si dhe mënyra e promovimit të sponsorizuesit.

Projektligji përcakton subjektet që mund të përfitojnë nga donacionet dhe sponsorizimet. Organet publike mund të jenë përfituese të donacioneve dhe të sponsorizimeve sipas kushteve të përcaktuara në projektligj, ndërsa për sponsorizimet parashikohen si përfitues edhe organizatat jofitimprurëse, organizatat sportive, shoqëritë sportive, subjektet tregtare në fushën e prodhimit të filmit dhe industrisë audiovizive, botuesit e shtypit dhe botimeve shkencore dhe enciklopedike, si dhe individët që përfaqësojnë Republikën e Shqipërisë në aktivitete ndërkombëtare në fushën e artit, kulturës dhe sportit. Përcaktimi i këtyre kategorive synon të krijojë qartësi dhe siguri juridike për subjektet, që mund të përfitojnë mbështetje sipas këtij ligji.

Projektligji rregullon format e donacioneve e të sponsorizimeve dhe parashikon rregulla të posaçme për mbështetjen e projekteve infrastrukturore publike, përfshirë metodologjinë e vlerësimit të tyre. Në këtë mënyrë mundësohet mbështetja e veprimtarive me interes publik në forma të ndryshme, duke garantuar njëkohësisht dokumentimin, evidentimin dhe vlerësimin e kontributeve të dhëna.

Një nga risitë kryesore të projektligjit është krijimi i bazës së të dhënave shtetërore "Regjistri Elektronik Kombëtar i Sponsorizimeve", i cili administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Në këtë regjistër regjistrohen sponsorizimet e kryera sipas këtij ligji, pavarësisht vlerës së tyre. Deklarimi dhe regjistrimi i sponsorizimeve realizohen nëpërmjet shërbimit elektronik të posaçëm në platformën qeveritare "*e-Albania*". Regjistri synon të rrisë transparencën dhe gjurmueshmërinë e sponsorizimeve, të mundësojë administrimin e verifikimin e të dhënave dhe të krijojë mekanizma më efektivë të monitorimit e të kontrollit.

Projektligji përcakton rregullat për të dhënat që administrohen në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve, dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera shtetërore të të dhënave, afatet dhe përgjegjësitë për deklarimin dhe regjistrimin, si dhe nivelet e aksesit dhe publikimit të informacionit. Administrimi dhe përpunimi i këtyre të dhënave kryhen duke respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore, qeverisjen elektronike, sigurinë kibernetike, të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Për organet publike, projektligji vendos kërkesa të posaçme për pranimin e donacioneve dhe sponsorizimeve, me qëllim garantimin e transparencës dhe shmangien e konfliktit të interesit. Për donacionet parashikohet verifikimi paraprak i kushteve ligjore dhe i konfliktit të interesit, formalizimi me marrëveshje të shkruar në rastet e parashikuara në ligj, si dhe detyrime për evidentimin, publikimin dhe raportimin e tyre. Për donacionet nga persona fizikë ose juridikë të huaj parashikohet marrja e miratimit të organit epror, sipas përcaktimeve të projektligjit. Këto masa synojnë forcimin e llogaridhënies dhe integritetit në administrimin e mbështetjes së përfituar nga organet publike.

Projektligji përmban mekanizma për garantimin e integritetit të marrëdhënieve të donacionit dhe sponsorizimit. Për këtë qëllim, përcaktohen kufizime për kategoritë e personave që nuk mund të jenë donatorë ose sponsorizues, kërkesa për dokumentimin dhe verifikimin e tyre, ndalimi i donacioneve dhe i sponsorizimeve anonime, si dhe rregulla për parandalimin e shmangien e konfliktit të interesit. Këta mekanizma synojnë të kufizojnë mundësinë e përdorimit të donacioneve dhe sponsorizimeve për qëllime të paligjshme ose për ushtrimin e ndikimit të papërshtatshëm ndaj subjekteve përfituese.

Projektligji forcon gjithashtu mekanizmat e kontrollit financiar dhe të mbikëqyrjes institucionale. Donacionet dhe sponsorizimet u nënshtrohen kontrollit financiar dhe auditimit të jashtëm publik, sipas legjislacionit në fuqi, ndërsa administrata tatimore ushtron kompetencat e saj të verifikimit dhe kontrollit. Për sponsorizimet parashikohet gjithashtu raportimi mbi zbatimin e kontratës dhe përdorimin e sponsorizimit dhe regjistrimi i raportit përkatës në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve. Projektligji parashikon masa disiplinore dhe administrative për mosrespektimin e detyrimeve të përcaktuara në të.

Një element i rëndësishëm i projektligjit është rishikimi i regjimit të lehtësive tatimore për sponsorizimet në fushën e artit, kulturës dhe sportit. Për sponsorizuesit që kanë detyrim për pagesën e tatimit mbi fitimin parashikohet njohja e zbritjes së shumës së sponsorizuar e të dokumentuar, brenda kufijve dhe kushteve të përcaktuara në projektligj. Mekanizmi shoqërohet me përcaktimin e kufirit maksimal të lehtësisë, kufirit maksimal vjetor të sponsorizimit për një sponsorizues dhe kufirit të përgjithshëm vjetor të sponsorizimeve që mund të përfitojnë nga kjo skemë.

Përpara lidhjes së kontratës së sponsorizimit në fushat e artit, kulturës dhe sportit, projektligji parashikon që ministria përgjegjëse, me kërkesë të përfituesit, të lëshojë vërtetimin se veprimtaria, objekt sponsorizimi, zhvillohet në këto fusha dhe përbën veprimtari me interes publik. Ky vërtetim nuk përbën vendim për

përfitimin e lehtësisë tatimore. Përfitimi i lehtësisë realizohet sipas mekanizmit dhe procedurës së posaçme të parashikuar në projektligj, përfshirë autorizimin nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Kjo skemë synon të nxisë mbështetjen private për artin, kulturën dhe sportin, duke garantuar në të njëjtën kohë kontrollin e përdorimit të lehtësive tatimore.

Të ardhurat e përfituara nga sponsorizimi përjashtohen nga tatimi për përfituesin e sponsorizimit. Ky përjashtim nuk zbatohet për pjesën e fondeve të sponsorizimit, që përdoret për pagesën e shpërblimeve ose honorarëve, të cilat i nënshtrohen tatimit në burim, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat. Detyrimi për pagimin e këtij tatimi i ngarkohet subjektit përfitues të sponsorizimit. Ky rregullim synon të ruajë karakterin nxitës të mekanizmit të sponsorizimeve, duke garantuar njëkohësisht trajtimin tatimor të shpërblimeve dhe honorarëve të paguara nga fondet e sponsorizimit.

Projektligji parashikon gjithashtu një periudhë kalimtare për krijimin dhe vënien në funksion të Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve dhe të shërbimit elektronik përkatës. Deri në funksionimin e plotë të tyre, të dhënat për sponsorizimet deklarohen dhe administrohen sipas mekanizmit të përkohshëm të përcaktuar në projektligj dhe transferohen më pas në Regjistër. Ky mekanizëm synon të garantojë vazhdimësinë e zbatimit të ligjit gjatë periudhës së ngritjes dhe funksionalizimit të infrastrukturës elektronike.

Në tërësi, projektligji pritet të përmirësojë ndjeshëm kuadrin ligjor për donacionet dhe sponsorizimet, të rrisë transparencën, llogaridhënien dhe gjurmueshmërinë e sponsorizimeve, të forcojë mekanizmat e integritetit dhe të kontrollit dhe të krijojë një mjedis më të qartë, të sigurt dhe të parashikueshëm për mobilizimin e burimeve private në mbështetje të veprimtarive me interes publik. Në të njëjtën kohë, mekanizmat e dokumentimit, regjistrimit, verifikimit dhe kontrollit synojnë të zvogëlojnë rreziqet e konfliktit të interesit, korrupsionit, pastrimit të produkteve të veprës penale dhe financimit të terrorizmit, duke garantuar mbrojtjen e interesit publik dhe përdorimin e ligjshëm e transparent të donacioneve dhe të sponsorizimeve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË,KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, përfshirë legjislacionin për të drejtën e informimit, parandalimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesave, parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe ligjin për organizatat jofitimprurëse. Gjatë procesit të hartimit

janë marrë në konsideratë gjithashtu praktikat më të mira dhe modelet krahasuese të disa shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendeve të rajonit, përfshirë Francën, Italinë, Gjermaninë, Poloninë dhe Kosovën, me qëllim ndërtimin e një kuadri ligjor modern, të harmonizuar e të zbatueshëm në praktikë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Ky projektligj nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji "Për donacionet dhe sponsorizimet" synon krijimin e një kuadri ligjor të plotë dhe të unifikuar për rregullimin e donacioneve dhe sponsorizimeve në Republikën e Shqipërisë, duke zëvendësuar legjislacionin ekzistues për sponsorizimet dhe duke përcaktuar rregulla për transparencën, integritetin institucional, gjurmueshmërinë, parandalimin e konfliktit të interesit, kontrollin dhe raportimin, si dhe përfitimin e lehtësive tatimore, sipas kushteve të përcaktuara në projektligj.

Projektligji përbëhet nga 32 nene të organizuara në katër krerë.

Kreu I përmban dispozitat e përgjithshme të projektligjit dhe përcakton objektin, fushën e zbatimit, përkufizimet, subjektet, parimet, format e donacioneve dhe sponsorizimeve, kufizimet, rregullat për dokumentimin dhe verifikimin, Regjistrin Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve, konfliktin e interesit, raportimin, kontrollin financiar dhe regjimin e lehtësive tatimore.

Fusha e zbatimit përfshin mbështetjen e veprimtarive me interes publik, ndër të tjera, në fushën e shërbimeve sociale dhe të veprimtarive humanitare, artit, kulturës dhe mbrojtjes së trashëgimisë, zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve dhe të të rinjve, shëndetit publik dhe kujdesit shëndetësor, mbrojtjes së mjedisit dhe klimës, sportit, infrastrukturës sportive dhe edukimit fizik, arsimit, rinisë, kërkimit shkencor, inovacionit dhe transformimit digjital, të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, demokracisë, shtetit të së drejtës, mirëqeverisjes dhe luftës kundër korrupsionit, lirisë së medias, si dhe projekteve infrastrukturore publike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Projektligji përcakton dallimin ndërmjet donacionit dhe sponsorizimit dhe vendos rregullat përkatëse për secilën prej këtyre marrëdhënieve. Për sponsorizimet parashikohet lidhja e kontratës me shkrim, ku përcaktohen elementet e

marrëdhënies së sponsorizimit, përfshirë objektin, qëllimin, formën dhe vlerën e sponsorizimit, destinacionin dhe përdorimin e tij, si dhe mënyrën e promovimit të sponsorizuesit.

Projektligji përcakton gjithashtu kategoritë e subjekteve përfituese. Organet publike mund të jenë përfituese të donacioneve dhe sponsorizimeve sipas kushteve të parashikuara në projektligj, ndërsa sponsorizimet mund të përfitohen edhe nga organizatat jofitimprurëse, organizatat sportive, shoqëritë sportive, subjektet tregtare në fushën e prodhimit të filmit dhe industrisë audiovizive, botuesit e shtypit dhe botimeve shkencore dhe enciklopedike, si dhe individët, që përfaqësojnë Republikën e Shqipërisë në veprimtari ndërkombëtare në fushën e artit, kulturës dhe sportit.

Projektligji rregullon format e lejueshme të donacioneve e të sponsorizimeve dhe përcakton mënyrën e dokumentimit dhe, sipas rastit, të vlerësimit të tyre. Për projektet infrastrukturore publike parashikohet miratimi, me vendim të Këshillit të Ministrave, i metodologjisë përkatëse të vlerësimit.

Për garantimin e integritetit të marrëdhënieve të donacionit dhe sponsorizimit, projektligji përcakton kufizime për personat që mund të jenë donatorë ose sponsorizues, kërkesa për dokumentimin dhe verifikimin e tyre, ndalimin e donacioneve dhe të sponsorizimeve anonime, si dhe rregulla për parandalimin e shmangien e konfliktit të interesit.

Një nga risitë kryesore të projektligjit është krijimi i bazës së të dhënave shtetërore "Regjistri Elektronik Kombëtar i Sponsorizimeve", i administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Në Regjistër regjistrohen sponsorizimet e kryera sipas ligjit, pavarësisht vlerës së tyre, ndërsa deklarimi dhe regjistrimi realizohen nëpërmjet shërbimit elektronik të posaçëm në platformën qeveritare "*e-Albania*". Projektligji përcakton të dhënat që administrohen në Regjistër, dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera shtetërore të të dhënave, afatet e regjistrimit, nivelet e aksesit, si dhe rregullat për publikimin e mbrojtjen e të dhënave.

Projektligji parashikon gjithashtu raportimin për zbatimin e kontratës dhe përdorimin e sponsorizimit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe mekanizmat e kontrollit financiar dhe tatimor, me qëllim garantimin e përdorimit të ligjshëm të donacioneve e të sponsorizimeve dhe verifikimin e respektimit të detyrimeve të parashikuara në ligj.

Neni 14 parashikon regjimin e përgjithshëm të lehtësive tatimore për sponsorizimet, ndërsa neni 15 parashikon regjimin e posaçëm të lehtësive tatimore për sponsorizimet në fushën e artit, kulturës dhe sportit. Në këtë kuadër,

projektligji parashikon mundësinë e përfitimit të lehtësisë tatimore, sipas kushteve, kufijve dhe procedurave të përcaktuara në nenin 15 dhe në aktet e nxjerra në zbatim të tij. Përfitimi i lehtësisë tatimore lidhet me realizimin dhe dokumentimin e sponsorizimit, në përputhje me kërkesat e projektligjit dhe legjislacionin tatimor në fuqi. Të ardhurat e përfituara nga sponsorizimi përjashtohen nga tatimi për përfituesin, ndërsa shumat e përdorura për pagesën e shpërblimeve ose honorarëve i nënshtrohen tatimit në burim, i cili paguhet nga subjekti përfitues sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat. Neni 16 rregullon të drejtën e ankimit ndaj vendimmarrjes së administratës tatimore, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Regjimi i posaçëm i lehtësive tatimore, i parashikuar në nenin 15, synon të nxisë financimin privat të veprimtarive në fushën e artit, kulturës dhe sportit, në funksion të objektivave të politikave publike në këta sektorë. Veprimtaritë në fushat e tjera të interesit publik, të përcaktuara në nenin 2, përfshirë demokracinë, shtetin e së drejtës, mirëqeverisjen, luftën kundër korrupsionit, lirinë e medias dhe të drejtat e njeriut, mund të mbështeten nëpërmjet sponsorizimeve, sipas rregullave të përgjithshme të projektligjit.

Parashikimi i një mekanizmi të posaçëm nxitës për sponsorizimet në fushën e artit, kulturës dhe sportit mbështetet në karakteristikat objektive të këtyre sektorëve dhe në përfitimet publike, që lidhen me zhvillimin e tyre. Veprimtaritë në fushën e artit e të kulturës kontribuojnë në mbrojtjen dhe në promovimin e trashëgimisë kulturore, zhvillimin e krijimtarisë, edukimin kulturor, pjesëmarrjen qytetare, kohezionin shoqëror dhe promovimin ndërkombëtar të vendit. Veprimtaritë sportive kontribuojnë në edukimin fizik, përfshirjen sociale, zhvillimin e fëmijëve dhe të të rinjve, nxitjen e pjesëmarrjes e të vullnetarizmit, si dhe përfaqësimin e vendit në veprimtari sportive kombëtare dhe ndërkombëtare.

Përfitimet që krijohen nga këto veprimtari shtrihen përtej interesit ekonomik të përfituesit të drejtpërdrejtë dhe financimi i tyre nuk mund të mbështetet në çdo rast vetëm në të ardhurat që gjenerohen nga veprimtaria përkatëse. Për këtë arsye, lehtësia tatimore synon të nxisë mobilizimin e burimeve private, diversifikimin e burimeve të financimit dhe rritjen e mbështetjes për realizimin e veprimtarive me interes publik në këto fusha.

Ky arsyetim është në përputhje me standardet evropiane, që kërkojnë që përfitimet tatimore të mbështeten në kritere objektive, të justifikueshme dhe proporcionale, pa krijuar favorizim arbitrar të fushave të caktuara. Në këtë drejtim, diferencimi i parashikuar në projektligj mbështetet në qëllimin dhe në karakteristikat e mekanizmit fiskal të zgjedhur dhe nuk kufizon të drejtën e subjekteve, që veprojnë në fusha të tjera të interesit publik për të përfituar

sponsorizime, sipas rregullave të përgjithshme të projektligjit.

Regjimi i posaçëm vlerësohet gjithashtu në raport me parimin e proporcionalitetit të parashikuar në nenin 5 të projektligjit. Pra, mekanizmi:

- ndjek një qëllim legjitim të interesit publik;
- synon mobilizimin e financimit privat, në mbështetje të veprimtarive me interes publik;
- lidhet me sponsorizime të realizuara e të dokumentuara, sipas kërkesave ligjore;
- u nënshtrohet kufijve dhe kushteve të përcaktuara në projektligj e në aktet e nxjerra në zbatim të tij;
- nuk kufizon të drejtën për të përfituar sponsorizime në fushat e tjera të interesit publik;
- u nënshtrohet verifikimit dhe kontrollit, sipas legjislacionit tatimor dhe dispozitave të projektligjit.

Në vlerësimin e këtij mekanizmi janë marrë në konsideratë edhe parimet e përcaktuara në *Joint Guidelines on Freedom of Association* të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias, CDL-AD (2014)046, lidhur me krijimin e një mjedisi ligjor e fiskal mundësues për organizatat. Në këtë kuadër, trajtimi i diferencuar mund të mbështetet në kritere objektive dhe në një nevojë të justifikueshme, por nuk duhet të përdoret për të krijuar diskriminim ndërmjet organizatave në varësi të natyrës së veprimtarisë së tyre.

Për këtë arsye, zbatimi i lehtësive tatimore duhet të mbështetet në kritere objektive dhe të zbatueshme në mënyrë të barabartë për subjektet që ndodhen në të njëjtat kushte ligjore. Qëndrimet politike, funksionet advokuese, monitoruese ose kritike të një organizate, si dhe marrëdhënia e saj me autoritetet publike nuk duhet të përbëjnë në vetvete kriter për përfitimin ose mospërfitimin e lehtësive të parashikuara nga projektligji.

Në këtë drejtim, është marrë në konsideratë edhe rekomandimi i Komisionit (BE) 2023/2836, datë 12 dhjetor 2023, për promovimin e angazhimit dhe të pjesëmarrjes efektive të qytetarëve dhe të organizatave të shoqërisë civile në proceset e politikëbërjes publike. Në përputhje me parimet e këtij rekomandimi, kuadri rregullator për sponsorizimet synon të ruajë autonominë dhe pluralizmin e shoqërisë civile, të shmangë krijimin e barrës administrative joproporcionale dhe të sigurojë që rregullat e transparencës, verifikimit dhe kontrollit të zbatohen në mënyrë objektive e jodiskriminuese.

Në këtë mënyrë, regjimi i posaçëm i lehtësive tatimore për sponsorizimet në fushën e artit, të kulturës dhe të sportit synon të krijojë një mekanizëm nxitës të

përligjur nga objektivat e politikave publike në këta sektorë, duke ruajtur njëkohësisht mundësinë e financimit nëpërmjet sponsorizimeve të të gjitha fushave të tjera të interesit publik të parashikuara në projektligj dhe duke respektuar parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe pluralizmit të shoqërisë civile.

Kreu II përmban rregullat e posaçme për donacionet dhe sponsorizimet në organet publike, me qëllim garantimin e transparencës, integritetit institucional dhe parandalimin e konfliktit të interesit ose ndikimit të papërshtatshëm në ushtrimin e funksioneve publike.

Për donacionet në organet publike parashikohet verifikimi paraprak i konfliktit të interesit dhe i kushteve ndaluese për donatorët, si dhe formalizimi me marrëveshje të shkruar i donacioneve financiare me vlerë të barabartë ose më të madhe se 300 000 lekë, ose që arrijnë në mënyrë kumulative këtë vlerë nga i njëjti donator brenda një viti kalendarik. Projektligji përcakton gjithashtu detyrimet për evidentimin, publikimin dhe raportimin e donacioneve, si dhe rregulla të posaçme për donacionet nga persona fizikë ose juridikë të huaj.

Kreu përmban edhe rregullat e posaçme të zbatueshme për sponsorizimet nga organet publike dhe mekanizmat për garantimin e transparencës e të kontrollit të këtyre marrëdhënieve.

Kreu III rregullon përgjegjësinë për mosrespektimin e dispozitave të projektligjit. Ai parashikon masa disiplinore për personat përgjegjës në organet publike dhe kundërvajtje administrative për shkeljen e detyrimeve të deklarimit dhe regjistrimit të sponsorizimeve. Njëkohësisht, pika 1, e nenit 27, përcakton pasojat e mospublikimit nga organet publike, duke iu referuar detyrimeve përkatëse të projektligjit. Për donacionet, neni 24 rregullon publikimin e informacionit për donacionet e pranuara dhe, sipas rastit, të marrëveshjes së donacionit dhe të informacionit për përdorimin e tij. Për sponsorizimet, neni 21 rregullon publikimin e kontratës dhe të raportit për zbatimin e saj.

Gjithashtu, projektligji parashikon pasojat që lidhen me përfitimin e lehtësive tatimore në rastet kur sponsorizimet janë pranuar ose realizuar, në kundërshtim me kufizimet ligjore ose kur fshihen me dashje të dhëna që duhet të deklarohen në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve. Garantohet gjithashtu e drejta e ankimit, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Kreu IV përmban dispozitat kalimtare e të fundit, përfshirë nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit, masat për krijimin dhe vënien në funksion të Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve dhe shërbimit elektronik përkatës, ndryshimet në legjislacionin tatimor dhe shfuqizimin e legjislacionit

ekzistues për sponsorizimet.

Këshilli i Ministrave ngarkohet të miratojë aktet nënligjore të parashikuara në nenet 6, pika 5, dhe 9, pika 6, brenda 3 muajve, si dhe aktet e parashikuara në nenet 10, pika 13, 22, pika 5, dhe 24, pika 10, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. Ministri përgjegjës për artin, sportin dhe kulturën ngarkohet të miratojë, brenda 6 muajve, udhëzimet e parashikuara në nenet 18, pika 2, d 19, pika 3, ndërsa ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për artin, kulturën dhe sportin ngarkohen të miratojnë udhëzimin e përbashkët të parashikuar në pikën 5, të nenit 15.

Projektligji parashikon krijimin dhe vënien në funksion të Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve dhe të shërbimit elektronik përkatës brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. Deri në funksionimin e tyre, të dhënat deklarohen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe administrohen në evidencën e përkohshme të parashikuar nga projektligji, për t'u transferuar më pas në Regjistër.

Neni 31 parashikon shfuqizimin e ligjit nr.7892, datë 21.12.1994, "Për sponsorizimet", të ndryshuar, si dhe disa ndryshime në ligjin nr.29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, me qëllim harmonizimin e tij me regjimin e sponsorizimeve dhe të lehtësive tatimore të parashikuar në projektligj. Ndryshimet në këtë ligj përfshijnë shfuqizimin e shkronjës "g", të nenit 11, dhe të pikës 1/1, të nenit 40, si dhe riformulimin e shkronjës "p", të pikës 1, të nenit 50, që lidhet me trajtimin e shumave të sponsorizuara për efekt të përcaktimit të shpenzimeve të pazbritshme.

Neni 32 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit 15 ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare".

Në përfundim, projektligji krijon një regjim të ri të integruar për donacionet dhe sponsorizimet, duke ndërthurur rregullat për subjektet, dokumentimin, transparencën dhe kontrollin me regjistrimin elektronik të sponsorizimeve dhe mekanizmin e lehtësive tatimore. Nëpërmjet këtyre rregullimeve synohet rritja e transparencës dhe gjurmueshmërisë, forcimi i integritetit institucional dhe krijimi i kushteve për mobilizimin e burimeve private në mbështetje të veprimtarive me interes publik.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e projektligjit ngarkohen, sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë, Këshilli i Ministrave, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Turizmit,

Kulturës dhe Sportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe organet publike, që kanë detyrime sipas ligjit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve administron Regjistrin Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve, sipas nenit 10 të projektligjit. Për krijimin dhe vënien në funksion të Regjistrit dhe të shërbimit elektronik përkatës, ajo bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe institucionet e tjera përgjegjëse, sipas nenit 30 të projektligjit.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Procesi për hartimin e projektligjit filloi me ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës, me urdhrin nr.103, datë 17.7.2025, të Kryeministrit, dhe u vijua nëpërmjet një koordinimi të ngushtë ndërinstitucional, në kuadër të bashkëpropozimit të ministrit të Administratës Publike dhe ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit. Njëkohësisht, grupi ndërinstitucional i punës përbëhej edhe nga përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.

Në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës është parashikuar se ndryshimet ligjore do të parapriheshin nga një analizë ligjore brenda vitit 2025. Analiza ligjore paraprake u realizua nga Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion dhe u finalizua në gusht të vitit 2025. Paralelisht, sipas fushës së ekspertizës dhe përgjegjësive sektoriale, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit hartoi një analizë të dedikuar për sektorët e artit, kulturës dhe sportit, e cila kontribuoi në përgatitjen e projektligjit.

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, në cilësinë e sekretariatit teknik të grupit ndërinstitucional të punës, ka asistuar procesin në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësues të institucioneve të tjera pjesëmarrëse.

Hartimi i projektligjit është mbështetur e konsultuar ngushtësisht me ekspertë të fushës, kontributi i të cilëve ka përbërë një vlerë të shtuar në të gjitha fazat e procesit, si dhe me asistencën e drejtpërdrejtë teknike të Delegacionit të BE-së, nëpërmjet projektit EU4GG.

Konsultimi me Komisionin Evropian:

Projektligji iu nënshtrua konsultimit me Komisionin Evropian, në kuadër të angazhimeve të Shqipërisë për kapitullin 23. Në vijim të komenteve të Komisionit, u rishikuan dispozitat për gjurmueshmërinë, verifikimin paraprak, transparencën dhe përgjegjësinë e subjekteve përfituese. Neni 1 përcakton

shprehimisht si objektiva garantimin e gjurmueshmërisë së sponsorizimeve, zbatimin e rregullave për përfitimin e lehtësive tatimore dhe parandalimin e shmangies së detyrimeve ligjore.

Dokumentacioni dhe proporcionaliteti i kërkesave:

Në nenin 9, kërkesat për vërtetimet tatimore, doganore dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore zbatohen kur sponsorizuesi u nënshtrohet detyrimeve përkatëse në Republikën e Shqipërisë. Për sponsorizimet në favor të organizatave jofitimprurëse, kur vlera e përgjithshme nga i njëjti sponsorizues për të njëjtin përfitues gjatë një viti kalendarik nuk tejkalon 300 000 lekë, parashikohet dokumentacion i thjeshtuar, duke ruajtur kompetencën e autoriteteve për të verifikuar saktësinë e të dhënave të deklaruara. E njëjta vlerë shërben në nenin 24 si prag për formalizimin me marrëveshje të shkruar të donacioneve financiare për organet publike. Në të dyja rastet, pragu përshtat kërkesat dokumentare me vlerën e mbështetjes.

Parandalimi i konfliktit të interesit dhe kufizimet për organet publike:

Nenet 13 e 24 e vendosin verifikimin e konfliktit të interesit përpara lidhjes së kontratës së sponsorizimit ose pranimit të donacionit. Për donacionet, neni 24 përcakton gjithashtu përjashtimin nga procesi të personave që ndodhen në konflikt interesi dhe refuzimin e donacionit, kur konflikti nuk mund të menaxhohet ose kur pranimi mund të cenojë paanshmërinë dhe integritetin institucional. Propozimi për ndalimin e përgjithshëm të donacioneve nën një prag të caktuar u vlerësua joproporcional, pasi vlera e donacionit, e marrë më vete, nuk përcakton rrezikun e korrupsionit. Për kategoritë e organeve të përcaktuara në nenin 20, projektligji e kushtëzon pranimin me një lejim të shprehur në ligj të posaçëm. Rastet e lejuara u nënshtrohen garancive të transparencës, integritetit dhe kontrollit financiar.

Transparenca, gjurmueshmëria dhe kontrolli:

Sipas nenit 24, organet publike publikojnë në programet e tyre të transparencës informacion për çdo donacion të pranuar, pavarësisht vlerës, si dhe raportin vjetor për donacionet e refuzuara dhe arsyet e refuzimit. Për sponsorizimet, publikimi i kontratës dhe i raportit të zbatimit, sipas nenit 21, plotësohet nga regjistrimi elektronik i sponsorizimeve, sipas nenit 10. Këta mekanizma mundësojnë ndjekjen e mbështetjes së marrë dhe verifikimin e përdorimit të saj. Neni 17 parashikon mbajtjen e dokumentacionit të plotë nga organet publike, ruajtjen e dokumentacionit përkatës për të paktën pesë vjet dhe zbatimin e kontrollit financiar e të auditimit të jashtëm publik, sipas legjislacionit në fuqi. Referimi te kuadri i përgjithshëm i auditimit ruan pavarësinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit

në përcaktimin e përparësive të auditimit mbi bazën e riskut. Neni 25 plotëson këto garanci nëpërmjet rregulloreve të brendshme dhe planeve të integritetit.

Përgjegjësia administrative dhe pasoja tatimore:

Në vijim të komentit të Komisionit Evropian, u hoq gjoba e posaçme e parashikuar në versionin fillestar për përfituesin, që pranonte një sponsorizim në kundërshtim me nenin 7. Rishikimi mori parasysh nevojën për të dalluar sjelljen që i atribuohet përfituesit nga rastet kur ky i fundit është mbështetur në mirëbesim në dokumentacion të pasaktë ose çorientues të paraqitur nga sponsorizuesi. Neni 27 ruan përgjegjësinë administrative për shkeljet e detyrimeve të vetë përfituesit, përkatësisht deklarimin e pasaktë ose jashtë afatit dhe fshehjen me dashje të të dhënave. Referimi i drejtpërdrejtë te neni 7 ruan pasojën tatimore për sponsorizuesin në rastet kur sponsorizimi është pranuar në kundërshtim me ndalimet e atij neni.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji parashikon krijimin dhe vënien në funksion të Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve, i cili administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si dhe të shërbimit elektronik përkatës. Për realizimin e këtij parashikimi do të synohet, me përparësi, përdorimi dhe përshtatja e infrastrukturës, sistemeve dhe burimeve ekzistuese të institucioneve përgjegjëse.

Zbatimi i projektligjit mund të sjellë nevoja financiare, që lidhen me zhvillimin, përshtatjen, ndërveprimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve dhe të shërbimit elektronik përkatës. Gjithashtu, mund të nevojiten masa organizative dhe administrative për ushtrimin e funksioneve, që parashikohen nga ky projektligj, përfshirë mbështetjen administrative, aktivitetet informuese dhe ndërgjegjësuese, si dhe shpenzime të tjera operative, që lidhen me zbatimin e tij.

Çdo nevojë financiare, që mund të rezultojë nga zbatimi i ligjit, do të vlerësohet nga institucionet përgjegjëse, në përputhje me detyrimet e kompetencat e tyre, si dhe do të trajtohet sipas procedurave dhe rregullave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë. Ky projektligj nuk përbën në vetvete angazhim për alokim fondesh buxhetore.

Projektligji parashikon, gjithashtu, një mekanizëm kalimtar për deklarimin dhe administrimin e të dhënave deri në krijimin dhe vënien në funksion të Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve dhe të shërbimit elektronik përkatës, duke mundësuar zbatimin e ligjit edhe gjatë periudhës së ngritjes së

infrastrukturës elektronike.

Efekte në të ardhurat buxhetore mund të rezultojnë nga zbatimi i mekanizmit të lehtësive tatimore për sponsorizimet në fushën e artit, kulturës dhe sportit. Megjithatë, për shkak të mungesës së të dhënave të mjaftueshme statistikore dhe historike, ndikimi i tyre financiar nuk mund të vlerësohet me saktësi në këtë fazë. Projektligji përcakton kufijtë dhe kushtet për përfitimin e këtyre lehtësive, përfshirë kufirin maksimal për sponsorizues dhe kufirin e përgjithshëm vjetor të sponsorizimeve që mund të përfitojnë nga skema, me qëllim që zbatimi i saj të jetë i kontrolluar e proporcional me objektivat e ligjit.

Përfitimet e pritshme nga zbatimi i projektligjit lidhen kryesisht me rritjen e transparencës, të gjurmueshmërisë, integritetit dhe llogaridhënies në proceset e donacioneve dhe sponsorizimeve. Për shkak të natyrës së tyre dhe mungesës së të dhënave të nevojshme, këto përfitime nuk mund të vlerësohen në terma financiarë në këtë fazë.

KËSHILLI I MINISTRAVE